



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I" , Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 917/3 Prot.

Tiranë, më 29.01. 2016

**V E N D I M**  
**Nr. 12, datë 29.01.2016**

*“Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,  
filluar me Urdhrin nr. 917 prot., datë 11.12.2015”*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në përfundim të procedurës së mbikëqyrjes kryesisht, të kryer pranë Departamentit të Administratës Publike, në lidhje me informacionin e marrë nga emisioni FIKS FARE, për procedurat e konkurrimit, në të cilat kishte marrë pjesë shtetasi \*\*\*\*\*,

**VËREJ SE :**

Në datën 03.12.2015, në emisionin Fiks Fare, të transmetuar në televizionin kombëtar Top Chanel, është trajtuar një ankesë e shtetasit \*\*\*\*\* , në lidhje me moskualifikimin, sipas tij padrejtësisht, për të marrë pjesë në disa konkurreme, për vendet e lira të shpallura nga Departamenti i Administratës Publike, me pretendimin e mosplotësimit të kushteve dhe kërkesave specifike, që kërkonin pozicionet e punës, në të cilat kishte përzgjedhur për të marrë pjesë.

Duke marrë shkas nga ky informacion, si dhe nisur nga rëndësia madhe që ka zbatimi i drejtë dhe korrekt i procedurave të rekrutimit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Urdhrin nr. 917 prot., datë 11.12.2015, *“Për verifikimin e rastit të bërë publik nga media, pas ankesës së shtetasit \*\*\*\*\*, në emisionin Fiks Fare, të datës 03.12.2015, në televizionin kombëtar Top Channel”*, filloi kryesisht, procedurën për të verifikuar ligjshmërinë e veprimeve administrative të moskualifikimit të ankuesit për të marrë pjesë në konkurrimet e shpallura në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, me nr. 530 (Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar do të zhvillohej në datën 29.10.2015), 568 (Testimi me shkrim do të zhvillohej në datën 20.10.2015, kurse intervista e strukturuar, në datën 23.10.2015), 565 (Testimi me shkrim do të zhvillohej në datën 20.10.2015, kurse intervista e strukturuar, në datën 22.10.2015), 592 (Testimi me shkrim do të zhvillohej në datën 06.11.2015, kurse intervista e strukturuar, në datën 09.11.2015) dhe 593 (Testimi me shkrim do të zhvillohej në datën 09.11.2015, kurse intervista e strukturuar, në datën 12.11.2015).

Pas përfundimit të hetimit administrativ, rezultoi se shtetasi \*\*\*\*\* (në vijim kandidati \*\*\*\*\*), ka aplikuar për të marrë pjesë në 5 konkurrimet e mësipërme, duke paraqitur dokumentacionin përkatës.

Njësia përgjegjëse (DAP), pasi ka kryer verifikimin paraprak të dokumentacionit, në lidhje me përmbushjen ose jo nga ana e këtij konkurenti, të kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të pozicioneve të punës, të përcaktuara në shpalljet e mësipërme, ka vlerësuar të mos e kualifikojë si kandidat për konkurrim dhe në bazë të detyrimit që rrjedh prej Kreut III, pika 25, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”* dhe Kreut IV, pika 5, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, e ka njoftuar kandidatin se, për të gjitha pozicionet e punës që ai ka aplikuar, nuk është kualifikuar, për arsye të mosplotësimit të kriterëve dhe kërkesave të veçanta, të vendosura për secilin pozicion pune.

Për të arritur në një përfundim sa më objektiv, është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i paraqitur nga i interesuari që ishte administruar nga ana e Departamentit të Administratës Publike dhe është vlerësuar edhe një herë procesi i krahasimit të të dhënave të kandidatit (\*\*\*\*\*) me kriteret dhe kushtet e posaçme që kërkonin pozicionet e punës ku kishte aplikuar ai, të bëra publike në shpalljet zyrtare.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezultoi se, kandidati \*\*\*\*\* (\*\*\*\*\*), në të gjitha rastet ka aplikuar për pozicione pune, të cilat në bazë të pikës 8/b të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, janë pozicione pune të administrimit të posaçëm, pasi kanë të bëjnë me ushtrimin e përgjegjësiive specifike në një apo disa institucione të shërbimit civil dhe ushtrimi i tyre kërkon njohuri të posaçme, të një profesioni të caktuar apo të ngjashëm me të.

Në këtë kontekst, edhe në Vendimin nr. 142, dt. 12.3.2014, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”* e

Këshillit të Ministrave, në Lidhjen nr. 2, Klasa III/1, Klasa III/2 dhe Klasa IV/1, është përcaktuar se, kualifikimi arsimor për pozicionet e punës së administrimit të posaçëm duhet të jetë në nivelin “*Master Shkencor*”, duke kërkuar që kandidati në mënyrë të veçantë, të ketë njohuri të gjera dhe shumë të mira të specialiteteve brenda një fushe të caktuar profesionale dhe të politikave e programeve lidhur me fushën e specialitetit, gjë e cila prezumon kualifikimin e thellë në të njëjtën linjë shkencore, si në fazën e njohurive të përgjithshme (*Bachelor*), ashtu dhe në atë të njohurive të thella të posaçme (*Master Shkencor*).

Kjo është arsyeja që njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me institucionin përkatës që ka kërkuar plotësimin e pozicioneve e lira, në shpalljen e konkurrimit ka përcaktuar në mënyrë specifike kërkesën që, kualifikimi arsimor, si në nivelin “*Bachelor*” ashtu dhe në nivelin “*Master Shkencor*”, duhet t’i përkasin të njëjtës fushë.

Në rastin konkret, konstatohet se konkurrenti \*\*\*\*\*, në përgjithësi, paraqitet me një nivel të mirë formimi intelektual dhe ka mjaft kualifikime universitare e pasuniversitare, si në universitete të vendit ashtu dhe në universitete të huaja, por në ato pozicione ku ai ka aplikuar për konkurrim, nuk ka plotësuar kushtin e arsimit të thelluar, në të njëjtën linjë, si në nivelin e parë “*Bachelor*”, ashtu dhe në nivelin e dytë “*Master Shkencor*”, prandaj me të drejtë, në zbatim të kompetencës që i ka dhënë ligji për të realizuar këtë fazë (pika 3/a dhe 4 e nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Kreut III, pikat 22 deri 25, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*” dhe Kreut IV, pikat 2 deri 5, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”) njësia paraseleksionuese e Departamentit të Administratës Publike, nuk e ka kualifikuar atë për të marrë pjesë në ato konkurrime.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm, arrihet në përfundimin se njësia përgjegjëse, në rastet e mos kualifikimit të konkurrentit \*\*\*\*\*, ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*” dhe Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 14, 15 dhe 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; nenet 115, pika “a”, 116 pika “c” dhe 117, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative në R.SH*”; nenin 34 të Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

## **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit, të nisur kryesisht me Urdhrin nr. 917 prot., datë 11.12.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil *“Për verifikimin e rastit të bërë publik nga media, pas ankesës së shtetasit \*\*\*\*\*, në emisionin Fiks Fare të datës 03.12.2015, në televizionin kombëtar Top Channel”*, pasi nuk konstatohen shkelje të ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse (DAP), gjatë kryerjes së procedurës së pranimi në shërbim civil.
2. Të njoftohet për këtë vendim, Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**